



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20

Ref.: 579/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet kërkesa e Kosovo Art Academy nr.2130/19H, datë 31.10.2019 për riakreditim institucional.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

Kosovo Art Academy ka parashtruar kërkesë (nr. 2130/19H, më 31.10.2019) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim institucional dhe të programeve. Në mbledhjen e mbajtur më 16-17.01.2020, KShC ka shqyrtuar aplikacionin e Kosovo Art Academy dhe ka miratuar aplikacionin për akreditim institucional. Më datë 20 janar 2020, AKA ka njoftuar të gjitha institucionet e arsimit të lartë për vendimet e KSHC-së të marra në mbledhjen e 16-17 janarit 2020. Kosovo Art Academy ka dorëzuar Raportin e Vet-vlerësimit për akreditim institucional më 07.04.2020.

Sipas Udhëzimit Administrativ 15/18 për Akreditim të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, neni 10, pika 1.4.2. *"Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së vlerësuesve të jashtëm gjatë shqyrtimit të RVV-ve, dhe me qëllim që RVV-të të përmbajnë të dhëna të aktualizuara, RVV duhet të sillet në AKA, më së largu një muaj pas aprovimit formal të aplikacionit nga KSHC. Në rast se institucioni nuk arrin të dorëzojë RVV-në brenda afatit kohor prej një muaji, aplikacioni i institucionit procedohet në mbledhjen e KSHC-së për refuzim të aplikacionit."*

Në mbledhjen 82 të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të mbajtur më 25.06.2020, KShC ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe dokumentacionin përcjellës të saj, dhe ka konstatuar se RVV-ja është dorëzuar në AKA pas afatit të caktuar kohor, që është në kundërshtim me nenin e mësipërm të UA, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kosovo Art Academy;
- MASH-it;
- Arkivit të AKA-së.